



**GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA  
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVA**

C-IV-13-3383

27 shtator 2019

*Ankuesi*

ATK - Prishtinë

**Kundër**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 27 shtator 2019, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. Ankesa REFUZOHET si e pabazuar dhe vendimi i Autoritetit të Likuidimit vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 27 nëntor 2013, ATK (ATK) parashtrroi ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Dhoma e Posaçme) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin e mëtejshëm: AL ose AKP) nr. PEJ134-0002, të datës 11 nëntor 2013. Në vendimin e kundërshtuar, kërkesa e ankuesit për pagesën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), në shumë prej 190,375.13 €, për NSH “NT A”, në likuidim, është aprovuar pjesërisht për shumën prej 72,484.90 €, në pajtim me nenin 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tej Shtojca e Ligjit të AKP-së), ndërsa është refuzuar për shumën prej 117,890.23 €, si e pabazuar. Ankuesi propozoi që në pajtim me nenin 5 të Rregullores 2000/20 Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore, nenin 12.1 të Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 1/2000 për Organizimin dhe Procedurat e Administratës Tatimore, nenin 22 si dhe 42-49 të Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe

Procedurat, si dhe nenin 21 të Udhëzimit Administrativ (UA) nr. 05/2005 për zbatimin e Ligjit nr. 2004/48 Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, ankesa të aprovohet si e bazuar pasi tatimpaguesi nuk ka paguar brenda afatit të përcaktuar për pagesë, përkatësisht i nënshtrohet ndëshkimeve të përcaktuara me dispozitat ligjore. Ndëshkimet tatimore duhet të trajtohen në kategorinë e borgjit themelor siç e kërkon ligji. Për më tepër ndëshkimet dhe interesi nuk i përkasin kategorisë së njëjtë juridike ashtu sikurse i ka trajtuar AL. Mosnjohja e interesit në tërësi dhe trajtimi i ndëshkimeve në kategori të njëjtë tatimore me interesin nga ana e AL e dëmton pa të drejtë buxhetin e shtetit në vlerë prej 117,890.23 €. Në mbështetje të ankesës, ankuesi ka dorëzuar vendimin e kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit (më tej: AL) nr. PEJ134-0002, të datës 11 nëntor 2013 dhe dëshmitë në kopje si: Formularët e tre Kërkesave për Likuidim, të datës 13 shtator 2013, një ekstrakt / gjendje të tatimpaguesit - NSH-së, (shtypur me 18 nëntor 2013) dhe Listat e dorëzimit të tre kërkesave për pjesëmarrje në likuidim.

Në vendimin e kundërshtuar të datës 11 nëntor 2013, AKP-ja arsyetoi se sipas nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, kërkesa mund të përfshijë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës së kërkesës themelore. Bazuar në analizën e të paditurës shuma e pretenduar nga ankuesi në emër të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar ishte 190,375.13 €, nga e cila, shuma prej 65,895.36 € ishte shuma themelore, kurse shuma e ndëshkimeve ishte 124,479.77 €. Në këtë mënyrë shuma totale e aprovuar në emër të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar ishte shuma themelore prej 65,895.36 € plus 6,589.54 € (10 % i interesit të akumuluar të shumës themelore), apo gjithsej 72,484.90 €.

Me 03 shtator 2018, e paditura dorëzoi mbrojtjen e saj. E paditura pohon se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar në pajtim me nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit për AKP-në dhe se është e parëndësishme nëse shumat për tu paguar mbi kryegjënë janë të emërtuara “interes”, “kamatë”, “dënime”, “gjoha”, por se neni 37.3 i Ligjit 04/L-034 nuk lejon që këto shuma të llogaritura mbi shumën themelore të tejkalojnë 10 %. Si përfundim neni 37.3 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në nuk është në papajtueshmëri me ndonjë dispozitë tjetër të ligjit të aplikueshëm në Kosovë dhe edhe nëse ky do të ishte rasti, ky nen do të mbizotërojë në pajtim me nenin 31 të Ligjit nr. 04/L-034. Andaj propozon refuzimin e ankesës si të pabazuar si dhe vërtetimin e Vendimit të AL në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme -Ligji nr. 04/L-033.

Me 21 shtator 2018, ankuesi dorëzoi përgjigjen në mbrojtje.

Me 9 tetor 2018, e paditura dorëzoi kundërpërgjigjen e saj.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Sipas nenit 37.3 të Aneksit të Ligjit nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit “të gjitha kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shume themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore”.

Gjykata konstaton se kjo dispozitë ligjore mbizotëron mbi dispozitat e legjislacionit fiskal të parashtruara nga ankuesi. Procesi ligjor i likuidimit të NSH-ve është një procedurë kolektive ku ligjvënësi ka siguruar që ekziston mundësia që kreditorëve të renditur më ulët në renditjen e përparësisë së pagesave, t’ju paguhet diçka. Neni 37.3 ka rëndësi të madhe për këtë sepse përndryshe do të jetë edhe më e mundshme që të ardhurat nga asetet e likuiduara do të shfrytëzohen nga kërkesat me renditje më të lartë, sipas nenit 40, të cilat do të bëhen më të mëdha përmes akumulimit të kamatës mbi shumën themelore. Neni 37.3 parandalon këtë dhe kufizon shumën e kamatës në 10% të shumës themelore të kërkesës kreditore. Ai vepron me vetëm dy kategori ligjore, e para është shuma themelore e kërkesës kreditore dhe e dyta është kamata për shumën themelore të saj. Atë të cilën ankuesi po përpiqet të bëjë, se ndëshkimet dhe kamata janë dy kategori të ndara dhe të definuara si të tilla në legjislacionin fiskal, nuk është e vlefshme për këtë procedurë, sepse edhe dënimet llogariten lidhur me shumën themelore të kërkesës kreditore, pikërisht si kamata fiskale dhe për shkak të kësaj, ato bien në të njëjtën kategori të dytë të parashikuar nga neni 37.3, të kufizuara në 10 % të shumës themelore.

Kërkesa e tanishme e kreditorit është bërë në procedurat e likuidimit, të rregulluar me Ligjin nr. 04 / L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe rrjedhimisht, ky ligj mbizotëron mbi çdo dispozitë të legjislacionit Kosovar që nuk është në përputhje me të (neni 31.1). Një zgjidhje tjetër në lidhje me kreditorin fiskal, bazuar në cilësinë e ATK-së si autoriteti i vetëm i autorizuar për mbledhjen e tatimeve në Republikën e Kosovës, do të përbënte diskriminim në mesin e kreditorëve dhe nuk ka ndonjë mbështetje as në nenin 36 ose në cilëndo dispozitë tjetër të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Prandaj, bazuar në atë çfarë u tha më sipër dhe duke iu referuar nenit 74.4 të Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme, ankesa refuzohet si e pabazuar.

### **Taksa gjyqësore**

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06 / L-086), ankuesi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta.

Në pajtim me nenin 63 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme dhe në lidhje me nenin 8.2 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi lirohet nga pagesa e taksave gjyqësore.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Sylejman Shumolli**  
Gjyqtar

### **Urdhër për zyrën e regjistrimit**

Aktgjykimi duhet t'i dorëzohet palëve.